



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINSTRAVE

V E N D I M

Nr. 456, datë 10. 6. 2020

“PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 910
DATË 21.12.2016 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ÇËSHTJET,
OBJEKT KONSULTIMI DHE STRUKTURËN, PROCEDURËN,
FORMËN, MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË
KËSHILLIT KONSULTATIV TË QEVERISJES QENDRORE ME
VETËQEVERISJEN VENDORE” TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

- I. Në vendimin nr. 910, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
 1. Në shkronjën “c” të pikës 4, pas nënndarjes “viii” “mbrojtjen e konsumatorëve” shtohet nëbdarja “ix”, me këtë përmbajtje:
“ix: diaspora dhe migracioni;”.
 2. Në pikën 7, të kreut III, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
 - a) Në fjalinë e parë, numri “9 (nëntë)” zëvendësohet me numrin “11 (njëmbëdhjetë)”,



b) Pas nënndarjes “zëvendësministri përgjegjës për arsimin” shtohen nënndarjet, me këtë përmbajtje:

“ - Përfaqësuesi i ministrit përgjegjës për marrëdhëniet me diasporën;

- Përfaqësuesi i ministrit përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes.”.

c) Fjalët “...2 kryetarë bashkie...” zëvendësohen me “...3 (tre) kryetarë bashkie...”.

II. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministri i Shtetit për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I BRENDSHËM

SANDËR LLESHAJ

**MINISTRI I SHTESTIT
PËR DIASPORËN**

PANDELI MAJKO